



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë, 29.09.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 29.09.2020, të parashtruar nga Operatori Ekonomik, Grup i Operatorëve Ekonomik Haxhi Zenullahi B.I.; DT MINING SH.P.K. Llaushë, LLAUSHË, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Asfaltimi i rrugës së Shkupit dhe rrugës së Lumit në Gadime të Ulët me nr. të prokurimit: 613 020 067 521

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik Grup i Operatorëve Ekonomik Haxhi Zenullahi B.I.; DT MINING SH.P.K. Llaushë, LLAUSHË, të dt. 29.09.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i shkollës fillore në Lipjan" me nr. të Prok: 613 020 067 521

Vërtetohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë, N.T.SH. "Dino" Sh.p.k. Magjistratja Prishtine-Ferizaj, KONJUH, i datës 14.07.2020 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. Mbetet në fuqi Vendimi i AK për shpërblim me kontratë i publikuar me datë: 24.09.2020;
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, me datë 29.09.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pika e ankeses suaj është: qe OE i propozuar për kontratë në dokumentacionin e tij ka të bashkangjitur inxhinierin e Infrastruktura rrugore gjithashtu ka të bashkangjitur edhe kontratën e punës por i mungon nënshkrimi i OE

Ne kërkesat e AK tek kapaciteti teknik dhe profesional në njoftim për kontratë dhe Dosje të tenderit ka qene:

Kërkesa 2, pika b). Min Nje Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi infrastruktur rrugore, sistemi Bachelor ose master (min. 3 vjet provojë pune pas diplomimit) dhe si dëshmi është kërkuar:

Dëshmia 2. Lista e stafit duhet të dorzohet e nënshkruar dhe e vëlosur nga OE. a). Vendimi me shkrim mbi caktimin e menaxherit për këtë projekt i nënshkruar dhe vëlosur nga OE b). Për stafin profesional pika a,b,c të dëshmojnë me CV të nënshkruar nga vet inxhinieri, diplomat, Kontratat e punës ose parakontrata për këtë projekt dhe licenca e gjeodetit me afat. Për pikën d, Kontratat e punës ose parakontrata për këtë projekt.

Sqarim: OE i propozuar për kontratë ka të bashkangjitur inxhinierin e Infrastruktura rrugore poashtu ka të bashkangjitur edhe kontratën e punës për këtë inxhinier të nënshkruar nga vet inxhinieri.

Sa i përket qe OE nuk ka nënshkruar kontratën e punës për këtë inxhinier duhet të sqarojmë qe në dëshmitë e AK. Nuk është kërkuar qe kontratat e punës të jenë të nënshkruara dhe të vëlosura (shiqo kërkesën dhe dëshmitë me lartë) megjithatë kjo kontratë e punës për neve si AK është e pranueshme dhe është në bazë të kërkesave të AK, poashtu kontrata është e nënshkruar nga vet Inxhinieri që është i punësuar në këtë kompani.


Ky pretendim i juaji është i PABAZUAR

AK, konsideron se tenderi juaj është vlerësuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.


Adem Duriqi
Drejtor i Prokurimit